


# LegalNews

June 2023  
Qershor 2023

## **SPECIAL**



**Deloitte.**

Këshilli i Ministrave më datë 20.06.2023 i ka propozuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë projektligjin "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së Cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" (në vijim "Projektligji").

Ky Projektligj ka për qëllim të rregullojë dhe të garantojë procesin e kontrollit e të mbikëqyrjes së kultivimit, prodhimit dhe qarkullimit, si dhe eksportimin e bimës së Cannabis-it, të nënprodukteve të saj dhe produkteve përfundimtare për qëllime mjekësore dhe industriale.

Më konkretisht, ky Projektligj parashikon:

## I. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it ("Agjencia")

- Agjencia ka si mision mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së Cannabis-it dhe të prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore e industriale dhe monitorimin e zbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë Projektligj.
- Pranë Agjencisë ngrihet Komisioni i Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për kultivimin e Cannabis-it për qëllime mjekësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
- Agjencia krijon gjithashtu "Regjistrin Kombëtar të aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së Cannabis-it", i cili përmban të gjitha të dhënat e subjekteve të

On 20.06.2023, the Council of Ministers proposed to the Parliament of the Republic of Albania the draft law "On the control of the cultivation and processing of the Cannabis plant and the production of its by-products for medical and industrial purposes" (hereinafter the "**Draft Law**").

This Draft Law aims to regulate and guarantee the process of control and supervision of cultivation, production and circulation, as well as the export of the Cannabis plant, its by-products and final products for medical and industrial purposes.

More specifically, this Draft Law provides:

## I. Creation of the National Cannabis Control Agency ("Agency")

- The Agency's mission is the supervision, control and inspection of the cultivation and processing of the Cannabis plant and the production of its by-products for medical and industrial purposes and monitoring the implementation of the provisions provided for in this Draft Law.
- The License Commission is set within the Agency for the review and evaluation of requests submitted for obtaining a license for the cultivation of Cannabis for medical purposes, according to the provisions of this Draft Law.
- The agency also creates the "National Register of Licensed and Permitted Activities of the Cannabis Plant", which contains all the data of the licensed entities,

licencuara, përfshirë edhe llojet e farërave dhe fidanëve, sasinë e prodhuar, blerësit, produktet plehëruese, llojin e produkteve etj.

including the types of seeds and seedlings, the quantity produced, buyers, fertilizer products, type of products, etc.

## **II. Licencat për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e Cannabis-it mjekësor dhe kushtet e lidhura me to**

- Projektligji parashikon tre lloje licencash: për kultivim, transportim dhe eksportimin e Cannabis-it mjekësor.
- Licencat i jepen për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare subjekteve që plotësojnë kushtet e parashikuara.

## **II. Licenses for the exercise of activities related to the production of medical Cannabis and related conditions.**

- The Draft Law provides for three types of licenses: for cultivation, transportation, and export of medical Cannabis.
- Licenses are granted for a period of 15 (*fifteen*) years to entities that meet the required conditions.

## **III. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e Cannabis-it industrial dhe kushtet e lidhura me të**

- Leja për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e Cannabis-it industrial dhe kushtet e lidhura jepet nga Ministria e Bujqësisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare për fermerët e regjistruar, personin fizik, ose juridik.

## **III. Permit for the exercise of activities related to the production of industrial cannabis and related conditions.**

- The permit for the exercise of activities related to the production of industrial Cannabis and related conditions is granted by the Ministry of Agriculture for a period of 5 (*five*) years to registered farmers, natural or legal persons.

## **IV. Ndalime të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë është i ndaluar:**

- a) kultivimi i bimës së Cannabis-it mjekësor dhe prodhimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj, në tejkallim të dispozitave të këtij Projektligji;
- b) kultivimi i bimës së Cannabis-it dhe prodhimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj për qëllime mjekësore, tregtimi dhe posedimi i tyre nëse nuk janë të shënjuara dhe të gjurmueshme, sipas përcaktimeve në këtë Projektligj;

## **IV. General prohibitions in the Republic of Albania, it is prohibited to:**

- a) cultivate the medical Cannabis plant and the production of its by-products and final products, exceeding the provisions of this Draft Law;
- b) cultivate the Cannabis plant and production of its by-products and final products for medicinal purposes, their trading and possession if they are not marked and traceable, according to the provisions of this Draft Law;

- |   |   |
|---|---|
| <p>c) posedimi i mjeteve, pajisjeve dhe instrumenteve për prodhim të bimës së <i>Cannabis</i>-it mjekësor dhe nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj, përveç rasteve të deklaruara nga subjekti i pajisur me licencë, të parashikuara në këtë Projektligj;</p>   | <p>c) possess the tools, equipment and instruments for the production of the medical Cannabis plant and its by-products and final products, except for the cases declared by the entity equipped with a license, provided for in this Draft Law;</p>                  |
| <p>d) përdorimi i nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të bimës së <i>Cannabis</i>-it, përveç rasteve të parashikuara në këtë Projektligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;</p>  | <p>d) use by-products and final products of the Cannabis plant, except for the cases provided for in this Draft Law and in the special legislation in force;</p>  |
| <p>e) shitja dhe shpërndarja me pakicë apo shumicë, përvetësimi ose konsumi në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënprodukteve ose produkteve përfundimtare për qëllime mjekësore;</p>  | <p>e) sell, either retail or wholesale and distribute, acquire or consume in the territory of the Republic of Albania of by-products or final products for medical purposes;</p>  |
| <p>f) reklamimi i bërë në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose në çfarëdo mënyrë tjetër, pavarësisht mediumit të publikimit, të veprimtarisë së importimit të farës ose fidanit të <i>Cannabis</i>-it dhe kultivimit, prodhimit, shitjes, posedimit dhe përdorimit të bimës së <i>Cannabis</i>-it mjekësor;</p> | <p>f) advertise either directly or indirectly or in any other way, regardless of the medium of publication, of the activity of importing cannabis seeds or seedlings and the cultivation, production, sale, possession and use of the cannabis plant- medical it;</p> |
| <p>g) përpunimi dhe prodhimi, transporti, tregtimi dhe eksporti i nënproduktit dhe produktit përfundimtar të <i>Cannabis</i>-it mjekësor.</p>   | <p>g) the processing and production, transport, trade and export of the by-product and final product of medical Cannabis.</p>   |

## V. Sanksionet

- Projektligji parashikon sanksione administrative në rast të shkeljesh:
  - Gjoha të cilat variojnë nga 500.000,00 lekë (pesë qind mijë) deri 5.000.000,00 lekë (pesë milion); si dhe

## V. Sanctions

- The Draft Law provides administrative sanctions in case of violations:
  - Fines ranging from ALL 500,000.00 (*five hundred thousand*) to ALL 5,000,000.00 (*five million*); and

- Ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë nga 6 (gjashtë) muaj në 3 (tre) vjet.
- Në kushtet e konstatimit të shkeljeve të Kodit Penal, Agjencia raporton, në zbatim të parashikimeve të Kodit Penal, pranë autoriteteve përkatëse sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.
- Temporary suspension of activity from 6 (*six*) months to 3 (*three*) years.
- In the case of finding Criminal Code violations, the Agency shall report in accordance with the provisions of the Criminal Code, to the relevant authorities according to the provisions of the Code of Criminal Procedure.

**Projektligji është për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.**

**The Draft Law is currently under review by the Parliament of the Republic of Albania.**

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,  
Ish parku i mallrave,  
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3  
1001, Tirana, Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Sabina Lalaj**

Local Legal Partner  
Deloitte Legal sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,  
Ish parku i mallrave,  
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3  
1001, Tirana, Albania  
Mob: +355 68 37 33 130  
E-mail: [slalaj@deloitteCE.com](mailto:slalaj@deloitteCE.com)

## **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing’s affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte’s approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.